

**PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I
PROGRAMIT PËR
RIMËKËMBJEN EKONOMIKE
MASA 10: MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PROJEKTET
DHE INICIATIVAT QË SYNOJNË
PËRMIRËSIMIN E POZITËS SË
GRUAS NË SHOQËRI DHE
EKONOMI
FAZA DYTË**



Agjencia për Barazi Gjinore
Zyra e Kryeministrit të Kosovës

I. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, përmes këtij propozimi, prezanton modalitetet e zbatimit të **fazës së dytë të inisiativës “Sëbashku për rigjallërimin shoqëror dhe luftimin e pasojave të COVID-19”** të Masës 10-të të Planit të Zbatimit të Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike të Qeverisë së Kosovës, aprovuar me vendim të datës 13.08.2020, me nr.01/23 dhe Vendimin e dates 14/01/2021 Vendimi Nr.06/58. Masa 10 reflekton frymën dhe në zbatim të drejtëpërdrejtë të Programit të Qeverisë për Kosovën 2020-2023 përkitazi me synimet për promovimin e barazisë sociale, fuqizimit socio-ekonomik të grave, zhvillimit të qëndrueshëm gjithëpërfshirës, punësimit të të rinjve dhe grave, edukimit parashkollor dhe edukimit cilësor gjithëpërfshirës të djemve dhe vajzave. Njëkohësisht, Masa 10-të, me një buxhet total të akorduar Agjencisë prej 2 milionë EUROS, është në zbatim të drejtëpërdrejtë me objektivat e synuara në **Strategjinë Zhvillimore të Kosovës 2017-2021** dhe në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e ndërlidhura me ato në **Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024**.

Gjatë Fazës së Parë të zbatimit të Masës 10-të në periudhën shtator-dhjetor 2020, ABGj mbështeti suksesshëm 115 institucione të arsimit parashkollor në sektorin privat të shtrirë në të gjitha rajonet e Kosovës, të cilat përfituan sipas nevojave dhe u mbështetën prej një fondi prej 1 milionë EURO të ndarë nga buxheti i Kosovës në zbatim të Masës 10-të.

Në fazën e dytë, ABGJ kërkon qasje për pjesën e mbetur të buxhetit të akorduar, në totalin e 1 milion EURO-ve për mbështetjen e target grupeve të propozuara dhe miratura tashmë në koncept dokumentin **“Sëbashku për rigjallërimin shoqëror dhe luftimin e pasojave të COVID-19”**. Në bazë të këtij dokumenti, **target grupet** e propozuara në fazën e dytë janë si më poshtë vijon:

- a) gratë dhe vajzat që zotërojnë bizneset të vogla private, prodhuese apo shërbimesh (gastronomi, pastrim, rrobaqepësi, larje, ngjyrosje e pastrim kimik, prodhime arti dhe artizanale të trashëgimisë kulturore (punime në argjend, veshje, prodhime artistike), lulishtari, etj.
- b) gratë dhe vajzat të organizuara në forma të biznesit të tilla si kooperativa, B2B (business-to-business) të cilat ndodhen në linjën e parë të zinxhirit të prodhimit dhe furnizimit me lëndë të parë të konsumatorit individual, tregtar dhe/ose atij industrial të prodhimit masiv
- c) individë fizikë, të cilët ndërmarrin nisma vetëpunësimi prej të cilave punësohen dhe sigurojnë mirëqënien familjare dhe/apo të të ardhurave për përmbushjen e nevojave bazike,
- d) gra dhe vajza nga grupe të caktuara shoqërore (me aftësi të kufizuara, nëna vetëushqyese, punëtorë në tregun informal të punësimit, viktimat e dhunës në familje apo viktimat e dhunës seksuale të luftës, komunitete pakicë roma ashkali, egjiptas, etj.

ABGj, në shpërdarjen e mjeteve financiare dhe mbështetjen e grupeve të lartpërmendura do të veprojë përmes organizatave të regjistruara dhe që veprojnë si persona juridikë në bazë të kornizave

ligjore të Kosovës. Në përzgjedhjen e organizatave zbatuese do të kihet parasysh parimet e ekspertizës dhe eksperiencës në zhvillimin dhe mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, qasjes në tregun e punës dhe shërbimeve në komunitet, me target grupe e grave dhe vajzave të listuara më sipër.

ABGJ do të sigurojë shpërndarjen e fondeve në bazë të *Ligjit të Kosovës për Financat Publike dhe Rregulloren MF Nr-04/2017, Mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve* dhe do të ushtrojë të drejtat dhe detyrimet për monitorimin, raportimin dhe llogaridhënien në baza të rregullta periodike dhe në zbatim të instrumenteve të monitorimit, auditimit dhe ushtrimit të kontrollit dhe uljes së rrezikut të parapara në instrumente e sisteme të politikë zbatimit të Qeverisë së Kosovës dhe atyre të krijuara posaçërisht për mbarëvajtjen e zbatimit të fazës së dytë në kuadër të nismës **“Sëbashku për rigjallërimin shoqëror dhe luftimin e pasojave të COVID-19”**, të ndërmarrë në përputhje dhe aprovim të Masës 10-të të *Planit të Zbatimit të Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike të Qeverisë së Kosovës*.

ABGJ ruan të drejtën, për të bërë ndryshime mbi detyrimet që burojnë nga *Rregullorja MF Nr-04/2017, Mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve*, ndryshime këto që përmirësojnë efektivitetin e punës dhe reflektojnë kushtëzimet e veprimeve në terren në përputhje me masat e shpallura për luftimin e COVID-19. E drejta për ndryshime apo për mosreflektim të neneve të Rregullores bazohet në Nenin 2, paragrafi 7-të të Rregullores, që parasheh si në vijim: *“Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk zbatohen edhe për mbështetjen financiare publike që jepet në gjendje të jashtëzakonshme siç parashihet me legjislacionin në fuqi, kur është e pamundur të pritet për të zhvilluar një thirrje publike në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.”* ABGJ do të sigurojë që ndryshimet që do të mund të ndodhin nuk prekin mirëmenaxhimin dhe mirëqeverisijen e parasë publike, zbatimin e transparencës dhe pjesëmarrjes, efektivitetin dhe eficiencën, dhe ushtrimin e llogaridhënies.

II. Arsyetimi

Agjencia për Barazi Gjinore sikurse e ka potencuar edhe në koncept dokumentin e aprovuar tashmë nga Qeveria e Kosovës në shtator të 2020, se adresimi i situatës së krijuar nga COVID-19 dhe qëndrueshmëria e këtyre investimeve dhe jetëgjatësia e tyre në një botë pas COVID-19 duhet të marrë në konsideratë dallimet e theksuara socio-ekonomike dhe kulturore që ekzistojnë në Kosovë mes burrave dhe grave.

Njëkohësisht, përtej dallimeve socio-ekonomike dhe normave kulturore, është e nevojshme të merret në konsideratë heterogjeniteti i grave dhe vajzave të cilat përfaqësojnë një grup të madh multi-dimensional, të cilat përpos përkatësisë së tyre gjinore, afektohen, paragjykojnë dhe përcaktohen në funksionet, pjesëmarrjen dhe identitetin e tyre nga përkatësitë arsimore, grupi shoqëror në bazë të të ardhurave apo pasurisë që posedojnë dhe ushtrojnë, profesionin, etnicitetin, vendndodhjes gjeografike (rurale vs. urbane, qendër vs. periferi), kombinuar me pozitën dhe kapacitetin vendim-marrës në familje, komunitet dhe shoqëri, shprehi dhe aftësi sociale dhe profesionale, puna për

përkujdesje, formaliteti vs. informaliteti i pjesëmarrjes në tregun e punës, pozita si nëna vetëushqyese, viktima të dhunës së familje, kryefamiljare, etj., shkalla e qasjes dhe cilësisë së qasjes në shërbime dhe infrastrukturë, mundësi për t'u informuar, etj. Të gjithë këta faktorë të listuar janë të gjithë faktorë të cilët mundësojnë pozitivisht dhe progresivisht ose në mungesë të tyre afektojnë një pjesëmarrje dhe qasje të barabartë të grave dhe vajzave në proceset e zhvillimit dhe transformimit të shoqërisë.

Në periudhën kohore, faktikisht 10 muaj e gjysëm nga shpallja e masave të para kundër COVID-19 në 13 mars 2020, situata e pandemisë nuk është përmirësuar; përkundrazi pas shtatorit 2020, situata shëndetësore ka ardhur duke u rënduar dhe funksionimi ekonomik në Kosovë dhe në vendet fqinje vjen duke u rënduar. Në këto kushte, kur thellimi i varfërisë për grupet që jetonin në varfëri para COVID-19 dhe rënia në varfëri e grupeve dhe individëve që jetonin në buzë të varfërisë është shtuar dhe pas monitorimeve të herëpashershme, kontakteve me organizata dhe shoqata që punojnë për fuqizimin ekonomik e shoqëror, me shoqata dhe organizata të cilat ofrojnë shërbime shoqërore në komunitet për gratë, të rinjtë dhe shtresa me aftësi të kufizuara dhe komunitete etnike, gjykojmë që është imperative **fillim-zbatimi i fazës së dytë të Masës 10-të.**

Për këtë fazë, ashtu sikurse është edhe parashikuar në koncept dokumentin e aprovuar në shtator të 2020 për Masën 10-të, pas suksesit të arritur me mbështetjen e institucioneve të arsimit parashkollor në sektorin privat, ABGj synon adresimin e përbushjes së synimit të fuqizimit ekonomik dhe përmirësimit të mirëqënies përmes mbështetjes së biznesit të vogël, të mesëm të organizuar në të gjitha format dhe ekonomitë: individuale, familjare, kooperativa, bashkime kreditore, të vogla apo të mesme. Njëkohësisht, duke vërejtur se shumë shtresa në nevojë kanë rënë në informalitet apo veprojnë në informalitet synon të adresojë këto çështje me synim zbutjen e varfërisë dhe minimizimin e informalitetit dhe pasojave të tij në periudhën e COVID-19 dhe në një realitet post-COVID-19.

Në këtë fazë, ABGj-ja do të sigurojë që investimi prej 1 milion EURO mbështet inisiativa ku sigurohet prodhimi ushqimit në burimin parësor të tij si dhe konservimi për periudha të shkurtëra dhe të gjata si dhe përpunimi pa humbje i prodhimeve nga prodhuesi te përpunuesi te konsumatori. Kjo jo vetëm do të sigurojë mbrojtjen ekonomive individuale, familjare, biznese por do të mbrojë mbi të gjitha mosprekjen e zinxhirit të prodhimit dhe të konsumit për të mundësuar siguruar sigurinë ushqimore si dhe për ta diversifikuar atë.

ABGj vëren se për shkak të kushteve të pandemisë, kontrolli i lëvizjes dhe masave shtrënguese për izolim të pjesshëm dhe në nivel kombëtar, të përkohshëm apo me afate të gjata e kanë prekur prodhuesin por edhe shpërndarësin dhe përpunuesin, e njëkohësisht dhe konsumatorin. Prodhimi bujqësor e blegtoral i prodhuesve të vegjël, ku gratë dhe vajzat janë dhe prodhuese të drejtëpërdrejta apo “të fshehura”, ose rrezikon të mbetet i pashitur në tregun ditor, apo i patërhequr nga përpunuesi i madh, çka do të thotë të përballemi me mungesa të artikujve ushqimorë, pamjaftueshmërinë e tyre në treg, shkatërrimin e prodhimeve për mungesë të qasjes në treg apo mostërheqjes së produktit nga përpunuesit ushqimorë, sektori gastronomisë dhe industrial, dhe çka do të sjellë rritjen e çmimit dhe

çmime të papërballueshme të prodhimeve për shumicën e konsumatorëve. Përtej kësaj, do të përballemi edhe me fenomene si mungesa e ushqimit, kequshqyerja dhe mosushqyerja adekuate çka rezulton në rënie të imunitetit të nevojshëm për të luftuar COVID-in por me pasoja shëndetësore afatgjata në mesin e popullatës, sidomos të shtresave në nevojë ku gratë dhe vajzat janë më të afektuarat duke qenë se do të vazhdojnë të sakrifikojnë në emër të familjes për arsye të normës kulturore.

Mbështetje duhet të sigurohet për gratë që punojnë apo drejojnë biznese të vogla në sektorin e shërbimeve. Sektori i shërbimeve është sektor ku punësohet një numër i madh i grave dhe vajzave, në mënyrë të veçantë kur këto biznese janë të natyrës së vetëpunësimit. Ky sektor sikurse dihet tashmë në masën më të madhe të natyrës së shërbimeve përballtet me efektet më të rënda të shkaktura nga pandemia dhe masat për luftimin e saj. Njëkohësisht duke qenë se këto janë biznese të vogla dhe u mungon edhe kapitali, edhe aftësia kursimit ndër vite, edhe mundësia për t'iu qasur skemave kreditore, rrjedhimisht ato janë të rrezikuara të shuhen në rast mosmbështetjeje duke sjellë kështu një humbje të madhe në pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në tregun e punës. Përmes këtij propozimi, grave dhe vajzave në bizneset e vogla si **gastronomi, pastrim, rrobaqepësi, larje, ngjyrosje e pastrim kimik, prodhime arti dhe artizanale të trashëgimisë kulturore (punime në argjend, veshje, prodhime artistike) ,lulishtari**, do ju jepet mundësia të që përmes mbështetjes financiare të vazhdojnë bizneset ose të adaptojnë bizneset e tyre në kushtete COVID-it dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë edhe të biznesit dhe produkteve të tyre dhe njëkohësisht pjesëmarrjen e pa shkëputje në tregun e punës.

Në këto rrethana dhe situata të panjohura më parë për vendin tonë, si dhe për vendet e zhvilluara, është e rëndësishme që të investohet gjithashtu në diversifikimin e biznesit, qasjen në teknologji të avancuara për prodhim, marketing, komunikim dhe menaxhim të informacionit, edukimit bazik financiar dhe menaxherial, burimeve bazike financiare me masa interesi të ulëta apo huave pa interes, gjetjes së partnerëve dhe investitorëve, regjistrimit të patentave dhe prodhimeve, transformimeve të bizneseve, etj.

Këto nevoja janë identifikuar edhe në dokumente më të hershme të ABGJ-së dhe përkojnë me politikat e aprovuara, çka do të thotë që në këtë situatë emergjente të kombinojmë me sukses nevojat e kahershme por që mbeten relevante, vazhdimin e zbatimit të politikave dhe premtimeve të bëra dhe maksimalizimit e investimeve që i kontribuojnë në fund të ditës: adresimit të situatës emergjente, qëndrueshmërisë së politikave të ndërmarra, transformimeve socio-ekonomike, avancimin e barazisë gjinore dhe luftimin e varfërisë.

III. Metodologjia e Zbatimit

Në shpërndarjen e fondeve dhe zbatimin e fazës së dytë të Masës 10-të, ABGj do të sigurojë ofrimin e mbështetjes financiare përmes bashkëpunimit me organizata të grave dhe atyre organizmave që

ofrojnë shërbime konsultative në biznese për rritjen, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe marketingut.

Organizatat e grave dhe organizmat e tjerë do të marrin pjesë përmes konkurrimit të hapur me kriteret të përcaktuara të cilat specifikohen në formë të detajuar në seksionin Annex të këtij dokumenti. Kriteret e përcaktura reflektojnë *Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës* dhe *Rregulloren MF Nr-04/2017, Mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve*, për menaxhimin e aspektit financiar dhe procesin administrativ të financimit të OJQ-ve. Njëkohësisht, ato reflektojnë kriteret e aplikimit të OJQ-ve për përmbushjen objektivave programatike të Masës 10-të. Forma e aplikimit dhe thirrja për aplikim do të përmbajnë kriteret më të detajuara teknike dhe të veprimit të cilat do të reflektojnë plotësisht kriteret dhe parimet e shprehura në këtë dokument, për një vlerësim adekuat të aplikimeve dhe për një zbatim rigoroz dhe efektiv të Masës 10-të.

Organizatat e grave dhe organizmat e tjerë që do të marrin pjesë përmes konkurrimit të hapur dhe me kriteret e përcaktuara, pas përfundimit të grantit, **do të jenë përgjegjëse për shpërndarjen e fondeve tek target grupet e përcaktuara**, qofshin këto biznese, individë fizikë apo organizata më të vogla që ofrojnë shërbime. ABGJ do të monitorojë periodikisht dhe rigorozisht zbatimin dhe shpërndarjen e fondeve të marra, për të siguruar cilësinë, përmbushjen e objektivave dhe lëvrimin e ndihmës te target grupet.

ABGJ do të sigurojë që para fillimit të shpërndarjes së fondeve dhe nënshkrimit të kontratave me OJQ-të përkatëse, përcaktimin e zonave gjeografike apo komuniteteve dhe sektorëve ekonomikë përkatës apo përcaktimin e hallkës së zinxhirit të prodhimit jo vetëm për të evituar duplikimet por mbi të gjitha për të rritur sinergjinë në bashkëpunimin tripalësh: *ABGJ-OJQ- Përfitues dhe* për të maksimalizuar efektivitetin dhe eficiencën e investimit. Kjo do të mbajë gjithashtu të ulur koston e investimeve të bëra dhe përkrahjen e një numri më të madh përfituesish.

ABGJ ruan të drejtën e përdorimit deri në masën 15% të totalit të fondit prej 1 milionë EUROsh për menaxhim të drejtëpërdrejtë në mbështetje të përfituesve të bizneseve të vogla dhe individëve fizikë.

ABGJ do të organizojë takime periodike individuale me OJQ-të për t'u informuar me progresin dhe sfidat në nivel organizativ dhe do të mbajë çdo dy muaj takime me të gjithë partnerët për të ndjekur ecurinë në grup dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për të matur arritjet, sfidat e hasura në bashkëpunim, diskutuar dhe aprovuar ndryshime në modalitete të qasjeve dhe risi që kontribuojnë në zbatimin e Masës 10-të. Në vijim, ABGJ do të sigurojë krijimin e sistemit të monitorimit që në fillim të zbatimit të Masës 10-të. Për secilin target grup që do të financohet nga Masa 10-të do të krijohet sistem të targetuar monitorimi me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, eficiencës së përdorimit të burimeve njerëzore për monitorim dhe mbajtjes së ulët të kostos financiare administrative të monitorimit. Në procesin e monitorimit, ABGJ dhe organizatat përfituese do t'i përmbahen kapitullit VI-të të *Rregullores MF Nr-04/2017, Mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve*.

Ndryshimet e mundshme që mund të ndodhin mbi mënyrat e aplikimit të monitorimit të parapara në Rregullore do të kushtëzohen vetëm nga detyrimi ligjor për respektimin e masave për luftimin e pandemisë. Aty ku vizita fizike nuk mund të kryhen në bizneset apo ndividët që kanë përfituar nga granti, do të shfrytëzohet teknologjia për komunikim në kohë reale dhe vëzhgim me perfituesit dhe bizneset e tyre.

IV. Target grupet dhe shpërndarja e fondeve

Ndonëse ABGj e ka qartësuar në koncept dokumentin e shtatorit të vitit 2020-të grupet e targetura nga zbatimi i Masës 10-të, në rikujtim dhe në formë më të zgjeruar dhe të grupuar, i cilëson në vijim:

- a) gratë dhe vajzat që zotërojnë bizneset të vogla private prodhuese apo shërbimesh (gastronomi, pastrim, rrobaqepësi, larje, ngjyrosje e pastrim kimik, prodhime arti dhe artizanale të trashëgimisë kulturore (punime në argjend, veshje, prodhime artistike), lulishtari, etj.
- b) gratë dhe vajzat të organizuara në forma të biznesit të tilla si kooperativa, B2B (business-to-business) të cilat ndodhen në linjën e parë të zinxhirit të prodhimit dhe furnizimit me lëndë të parë të konsumatorit individual, tregtar dhe/ose atij industrial të prodhimit masiv
- c) individë fizikë, të cilët ndërmarrin nisma vetëpunësimi prej të cilave punësohen dhe sigurojnë mirëqënien familjare dhe/apo të të ardhurave për përmbushjen e nevojave bazike, me synim zbutjen e varfërisë apo parandalimin e rënies në varfërinë absolute apo relative kombinuar me forma të tjera të varfërisë si kequshqyerja apo pamjaftueshmëria në ushqim, varfëria në mesin e fëmijëve, varfëria e feminizuar, varfëria nga diskriminimi, etj.
- d) gra dhe vajza nga grupe të caktuara shoqërore si: me aftësi të kufizuara, nëna vetëushqyese, punëtorë në tregun informal të punësimit, viktimat të dhunës në familje apo viktimat të dhunës seksuale të luftës, komunitete pakicë roma ashkali, egjiptas, etj.

ABGj planifikon shpërndarjen e 1 milionë EURO-ve për mbështetjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve që synojnë dhe rezultojnë në përmirësimin e situatës socio-ekonomike të grave dhe vajzave nga këto grupe shoqërore.

ANNEXES

ANNEX 1.

PROFILI I ORGANIZATAVE APLIKUESE

Profili i organizatave aplikuese duhet të përmbushi elementët e mëposhtëm:

- Të jenë të regjistruara sipas kuadrit ligjor në fuqi për ushtrimin e aktivitetit të tyre,
- Të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë dhe ekspertizë në mbështetjen e veprimtarive biznesore të grave dhe të rinjve dhe projekteve të tilla,
- Të kenë ushtruar mbështetjen e tyre në kontekst rural ose urban, ose në të dyja kontekstet për bizneset e grave dhe të rinjve,
- Të kenë protokolle dhe praktika veprimi të zhvilluara për të ndihmuar zhvillimin e bizneseve të grave dhe të rinjve dhe fuqizimin e tyre ekonomik, ose të cilat mund të përshtaten për këtë kontekst
- Të kenë ofruar shërbime në komunitet, shërbime të cilat në formë të drejtëpërdrejtë ose ndërthurrur lehtësojnë apo sigurojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në tregun e punës apo veprimtari biznesi, apo riformatimi profesional për të riorientuar dhe rritur shanset e punësimit të grave dhe vajzave
- Të kenë ofruar vlerësime të konteksteve socio-ekonomike dhe grupeve shoqërore të grave dhe vajzave të cilat kontribuojnë në formulimin apo korigjimin e politikave të ndërmarra në mbështetje të grave dhe vajzave dhe që avancojnë dhe kontribuojnë në qëndrueshmërinë e agjendës së barazisë gjinore,
- Të kenë ekspertizë profesionale brenda organizatës në përputhje me qëllimet e zbatimit të Masës 10 për grupet shoqërore të paracaktuara më sipër dhe për shumëllojshmërinë e natyrave të mbështetjes së biznesve dhe fuqizimit ekonomik në sektorë të ndryshëm ose kanë dëshmuar që mund ta sigurojnë atë sipas nevojave të përfituesve dhe në përmbushje të objektivave të projekteve dhe programeve në menaxhimin e tyre,
- Të kenë infrastrukturë ekzistuese për të siguruar mbarëvajtjen e projektit si p.sh.: zyrë pune, teknologji informative dhe komunikimi, mjete transportuese, etj.
- Të kenë struktura të kontrollit dhe mirëqeverisjes brenda organizatës së tyre,
- Të gjitha organizatat mund të mbështetin fillimin e bizneseve të reja. Fondi për bizneset e reja nuk mund jetë më shumë se 15% i shumës totale të fondeve për mbështetje, pas zbritjes së kostos administrative,
- Të kenë menaxhuar fonde jo më pak se 50,000 EURO dhe të jenë në gjendje të dëshmojnë përmes kontratave, marrëveshjeve apo letrave të referencës nga donatorët e mëparshëm. (Ky

element vlen për të gjitha organizatat të cilat kanë synim të aplikojnë për fonde jo më pak se 100,000 EURO).

- Të jenë në gjendje të dorëzojnë tabelat financiare për 3 vitet e fundit,
- Të kenë llogari bankare të regjistruar dhe në gjendje të qëndrueshme në një nga bankat që veprojnë brenda Kosovës,
- Të jenë të lirë nga detyrimet tatimore, detyrime financiare ndaj palëve të treta ose të kenë marrëveshje të shkruara për shlyerjen apo shtyrjen e shlyerjes së detyrimeve,
- Të kenë të paguar detyrimet tatimore për punonjësit e tyre,
- Të mos jenë në hetime,
- Të pranojnë të koordinohen dhe të monitorohen,
- Kostoja administrative e aplikimit nuk duhet të tejkalojë masën 22% të shumës totale të aplikimit.

Shënim. Detajet mbi prezantimin e buxhetit dhe mënyrën e organizmit dhe prezantimit të tij dhe propozimit për organizatat aplikuese do të ofrohen në format e detajuara të aplikimit.

OJQ-të përfituese që ofrojnë shërbime dokumentacioni e dorëzuar duhet ta kenë në përputhje me pikat 10 dhe 11 të *Rregullores MF Nr-04/2017, Mbi kriteret dhe standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.*

ANNEX 2.

FUSHAT E MBULUARA NGA FONDET E NDARA PËR MASËN 10-TË GJATË FAZËS SË DYTË

Fushat dhe shpenzimet e mëposhtëme janë orientuese dhe jo të gjitha fushat e mëposhtëme duhet të adresohen nga të gjithat organizata aplikuese. Organizatat aplikuese duhet të adresojnë ato fusha të cilat janë në përputhje me misionin dhe ekspertizën e tyre të dëshmuar përmes veprimtarisë së tyre dhe projekteve të zbatuara në vite, target grupet e përzgjedhura në përputhje me ato të listuara në këtë dokument dhe natyrën e sektorit dhe llojeve të bizneseve të përzgjedhura për të ndihmuar përmes propozimit që do të dorëzojnë. Fushat e mëposhtëme përcaktojnë standardin detyrues për organizatat aplikuese:

- a) për t'u orientuar në hartimin projekt propozimit dhe përlllogaritjen e buxhetit të aplikimit,
- b) për t'i përfshirë në formën e tyre të aplikimit për përfituesit e fondeve dhe për të qenë në gjendje të raportojnë pranë ABGJ-së me saktësi shpërndarjen e fondeve sipas fushave dhe natyrës së përfituesve.

Fushat e mbuluara nga fondet e Masës 10-të:

1. Pajisje dhe materiale biznesi të dorës së parë si: pajisje, materiale prodhimi që mundësojnë zhvillimin, prodhimin dhe konsolidimin e inisiativave biznesore,
2. Përmirësimin e kushteve infrastrukturore të biznesit të cilat mund të mbulojnë shpenzime për riparime të mjedisit ku ndodh biznesi apo mbulimin e shpenzimeve të qirasë për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj dhe jo më shumë se 500-euro në muaj,
3. Përmirësimin e kushteve biznesore për të përmbushur kushte higjieno sanitare në përputhje me masat anti-COVID ose që kërkohen për përmbushjen e standardeve për përftimin e licencave dhe për qarkullimin e prodhimeve në tregje brenda dhe jashtë Kosovës,
4. Mbulimin e shpenzimeve të mjeteve mbrojtëse kundër COVID-19 në mënyrë të veçantë në bizneset për përpunimin e produkteve ushqimore dhe shërbimeve gastronomike,
5. Rritjen e kapaciteteve magazinuese dhe zgjatjen e jetës së produkteve përmes përmirësimit të kushteve magazinuese dhe investimit përmes teknologjisë së përshtatshme,
6. Adaptimin e bizneseve në përgjigje të kushteve të COVID-19 me synim moslejimin e falimentimit të tyre apo rënies së prodhimit. Adaptimi mund të mbështetet edhe për biznese të cilat nuk mund të funksionojnë më sipas skemës apo natyrës së mëparshme por mund të shndërrohen përmes mbështetjes financiare dhe mund të shfrytëzojnë kapacitetet njerëzore dhe pajisjet e biznesit të mëparshëm, duke shmangur falimentimin,
7. Përmirësimin e cilësisë së prodhimeve dhe rritjes së prodhimit përmes mbështetjes së konsulencës biznesore në përputhje me standardet cilësore të përcaktura të tregut (shërbime

mercologjike, agrokulturore, veterinare, të përpunimit ushqimor apo industrive të tjera përpunuese),

8. Mbështetje dhe orientim profesional për regjistrimin e licencave dhe patentave,
9. Automatizimin e prodhimit, paketimin dhe zhvillimin e marketingut si qasje që sigurojnë vazhdimësinë e biznesit dhe sigurojnë distancimin social,
10. Mbështetje për transformimin dixhital të bizneseve përmes të cilave sigurohet dhe synohet: zbulimi i tyre nga konsumatori, hallkat e tjera të zinxhirit të prodhimit, bizneset dhe investitorët e interesuar, këtu përfshihen, por nuk kufizohen:
 - a. Marketing,
 - b. Eksporti,
 - c. Përdorimi i rrjeteve sociale,
 - d. Përmirësimi i monetizimit të prodhimeve përmes shitjes online, përfshi këtu dhe prodhime të artit dhe kulturës,
11. Mbështetje për zhvillimin e B2B (business to business),
12. Mbështetje për përfitim të huave dhe kredive të përshtatshme për bizneset nga institucione financiare,
13. Mbulimin e pagesës deri në katër muaj të maksimumit të dy punëtorëve të cilët punësohen nga bizneset kur këto të fundit duan të të zgjerojnë biznesin e tyre. Kjo aplikohet për biznese të cilat në momentin e marrjes së ndihmës kanë të punësuar nga një deri në pesë (5) punëtorë dhe kërkojnë të zgjerojnë bizneset e tyre (si p.sh. në sektorin e shërbimeve, pastrimit, etj.)
14. Ofrimin e trajnimeve për bizneset sipas moduleve përkatëse përkitazi me nivelin e dijës dhe avancimit të saj të përfituesve,
15. Ofrimin e shërbimeve në komunitet përmes përmirësimit të kushteve dhe që përmirësojnë kushtet higjieno-sanitare, nxitin pjesëmarrjen në tregun e punës dhe ulin informalitetin,
16. Ofrojnë vlerësime të konteksteve socio-ekonomike dhe grupeve shoqërore të grave dhe vajzave të cilat kontribuojnë në formulimin apo korrigjimin e politikave të ndërmarra në mbështetje të grave dhe vajzave dhe që avancojnë dhe kontribuojnë në qëndrueshmërinë e agjendës së barazisë gjinore.

ANNEX 3.

KRITERET E APLIKIMIT TË GRUPEVE PËRFITUESE

Me grupe të përfituesve do të kuptojmë individët që përfaqësojnë target grupet e cilësuar në faqen gjashtë (6) të këtij dokumenti. Të gjithë përfituesit në aplikimet e tyre për kualifikim duhet të dorëzojnë pranë institucionit përgjegjës për zbatimin e Masës 10-të dokumentet e mëposhtme:

1. Dokumentin e aplikimit në përputhje me kërkesat e dokumentit,
2. Fotokopje të objektit të identifikimit (letër-njoftim ose pasaportë)
3. Dëshminë që nuk është në hetime të lëshuar nga institucioni përgjegjës, jo më të vjetër se katër muaj,
4. Numrin e regjistrimit të biznesit,
5. Dëshminë e pagimit të taksave dhe tatimeve për vitin 2019-të dhe jo më larg se vitin 2018-të.
6. Dëshmi apo vërtetim të lëshuar nga donatorë të tjerë kur për aplikimin e dorëzuar është cilësuar së priten apo janë përfituar fonde për zbatimin e pjesshëm të tij,
7. Kontratat e qiramarrjes për objekte apo pajisje në shfrytëzim, për detyrimet ndaj të cilave kërkohen fonde dhe që i kontribuojnë vazhdimit apo zgjerimit të biznesit.
8. Të dorëzojnë listën e punonjësve për periudhën tetor 2019- mars 2020, për të cilët kanë derdhur detyrimet pensionale për vitet 2018, 2019. (**Shënim:ky kriter vlen vetëm për bizneset që punësojnë punonjës!**)

ANNEX 3. Nismat e propozuara dhe harmonizimi me kornizat e politikave publike

Nismat e Propozuara	Programi i Qeverisë	Strategjia Zhvillimore e Kosovës	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore	Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm	Detyrimet ndaj BE-së
Edukimi parashkollor ¹	<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i barazisë shoqërore Edukimi parashkollor Gjithëpërfshirja dhe barazi në arsim Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri 	Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor	<ul style="list-style-type: none"> Rritja e numrit të arsimit parashkollor dhe parafillor Subvencionimi i fëmijëve nga prindër vetëushqyes dhe përfitues të skemave sociale dhe të ardhura të ulëta 	Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë	Traktati i Lisbonës, Procesi i Kopenhagenit
Bizneset e grave	<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i barazisë shoqërore Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare. Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta. Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të 	<ul style="list-style-type: none"> Promovimi dhe zhvillimi i bizneseve në pronësi të grave përmes kredive dhe granteve Krijimi i strukturave stimuluese Rritja e ndërmarrësisë dhe punësimit në mesin e grave 	<ul style="list-style-type: none"> Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë 	Traktati i Lisbonës Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut

¹ Masa e zbatuar ne 2020

		shtuar.		dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë	
OJQ-të që ofrojnë shërbime	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i barazisë shoqërore • Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri • Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta. • Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i edukimit financiar • Ofrimi i shërbimeve ndaj shtresave në nevojë • Riformatizimi dhe zhvillimi i shprehive dhe shkathtësive sipas nevojave të tregut të punës 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit • Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurt, elastike (fleksibël) dhe të qëndrueshme 	Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut
Bizneset që punësojnë gra	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i barazisë shoqërore • Fuqizimi i pozitës së femrave në shoqëri • Zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja në lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve në grupime industriale të përafërta. • Përmirësimi i standardeve të cilësisë dhe kalimi në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës 	<ul style="list-style-type: none"> • Fund urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të të ushqyerit si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme • Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë 	Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut

				<p>dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë</p> <ul style="list-style-type: none">• Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat• Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj	
--	--	--	--	---	--

